




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË · OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilapenë Me Datën 30-04-2025			
Nr. Llogarit Org. Breg	Nr. Llogarit Org. Breg	Subjekti Përbërës	Vlera Vrednost
01-	110	05-	395



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, shkronja d, nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 2, pika 2.3 dhe neni 4 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-49, nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 29.04.2025 miraton këtë:

V E N D I M

për mbështetje financiare në shumën prej 3,500.00 euro për sindikatën (SPAK) e të punësuarëve në shërbimin civil të Komunës së Vitisë

Neni 1

Me këtë Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 3,500.00 euro (tremijë e pesëqind Euro), për Shoqatën Sindikale të Administratës Komunale të Vitisë.

Neni 2

Shuma e mjeteve të kërkuara nga Sindikata e Administratës Komunale në Viti në shumë prej 3,500.00 euro (tremijë e pesëqind Euro) do të sigurohet nga kodi buxhetor - subvencione dhe transfere nga Zyra e Kryetarit.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është kërkesa e sindikatës me numër protokolli 02-320/02-10047, e datës 17.04.2025.

Neni 4

Mjete nga neni 1 i këtij vendimi derdhen në gjyrollogarin bankare të sindikatës (SPAK) e të punësuarëve në shërbimin civil të Komunës së Vitisë.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 10, pika 6 të Ligjit për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Nr. 08/L-284 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27 Dhjetor 2024), dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhen zyrtare në web faqe të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. SPAK;
3. MAPL-së; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I

Bekim Azizi



BSPK



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITI

Pratëritja e Komititetit të Politikës dhe Financës	17-04-2025
Nr. Dokumenti	02-320/04-10047
Subjekt	Viti



DATE:	17.04.2025
PËRMES:	Shoqata Sindikale e Administratës Komunale SPAK në Viti
PËR/ZA/TO:	Kryetarit të Komunës z. Sokol Haliti Kryesuesin e Kuvendit të Komunës së Vitisë z. Bekim Azizi Komitetit për Politikë dhe Financa KK. Viti Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vitisë
NGA/OD/FROM	Xhelal Haxhiu – Kryetari i Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale në Viti (SPAK) në Viti Arian Alidema – Sekretari i SPAK në Viti
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për mbështetje financiare në vlerë prej 3500 euro për zhvillimin e aktiviteteve sindikale.

Të nderuar,

Kryetar i Komunës z. Sokol Haliti
Kryesuesin e Kuvendit të Komunës së Vitisë z. Bekim Azizi
Komitetit për Politikë dhe Financa
Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vitisë

Me anë të kësaj letre, Shoqata Sindikale e Administratës Komunale SPAK në Viti kërkon mbështetje tuaj financiare për realizimin e aktiviteteve të saj në kuadër të përfaqësimit dhe mbrojtës së të drejtave të anëtarëve tanë. Aktivitete përfshijnë: Organizmin e takimeve informuese dhe trajnimet e anëtarëve, promovimin e të drejtave të punëtorëve nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuere, mbështetje logjistike për pjesëmarrje në tryeza, organizimin e eventeve sindikale për forcimin e solidaritetit midis anëtarëve etj.

Duke qenë se këto aktivitete kërkojnë burime financiare të konsiderueshme, ju lutemi të konsideroni mundësinë për të na ndihmuar nëpërmjet një kontributi financiar në vlerë prej 3500 euro për vitin 2025 me qëllim realizimin e aktiviteteve të cekura më lartë por edhe aktiviteteve tjera marr parasysh se tash jemi në prag të datë 01 Maj cila është e njohur si **Dita e ndërkombëtare e punëtorëve ose Dita e punës**. Çdo ndihmë do të vlerësohet maksimalisht dhe do të kontribuoj ndjeshëm në fuqizimin e rolit të sindikatës si zë përfaqësues i denjë i shërbyesve civil.

Sa për rikujtim ne si shërbyes civil nga Komuna e Vitisë por edhe nga niveli qendror, deri me tash nuk kemi përfituar asnjëherë mbështetje financiare si Sindikate por edhe raste individuale, për dallim që stafi në Arsim dhe Shëndetësi këto vitet e fundit kanë përfituar përmes Kontratave Kolektive mjete financiare apo shuma të konsiderueshme financiare ndërsa mjetet financiare janë paguar nga buxheti komunal.

Një praktike e tillë e mbështetjes financiare për Sindikata për shërbyes civil këto vitet e fundit nëpër Komuna tjera të Republikës së Kosovës zbatohet dhe praktikohet çoft përmes vendimeve të Kryetarit të Komunës apo Vendimeve të Kuvendit të Komunës, përmes buxhetit nga Subvencionet dhe Transferet.

Provë: raste të përfitimit nga sindikata e shërbimit civil nga komunat tjera.

Ju falenderoj paraprakisht për konsideratën dhe mbështetjen tuaj.